



# MILIEUKONTAKT SHQIPËRI

RAPORT PËRMBLEDHËS | ECURISË  
2015-2020

## **Përmbajtja:**

<b>Mesazh nga Drejtuesja Ekzekutive.....</b>	<b>3</b>
Angazhimi ynë kombëtar përkrah shoqërisë civile .....	4
Angazhimi ynë ndërkombëtar.....	5
<b>Projektet e zhvilluara përgjatë viteve 2015-2020</b>	
A. Zhvillimi i Qëndrueshëm.....	7
B. Integrimi në BE.....	15
C. Qeverisje demokratike dhe ndërtim kapacitetesh.....	16
D. Mjedisi dhe shëndeti.....	25
E. Politika dhe legjislacioni mjedisor.....	37
<b>SHIKUESHMËRIA DHE MEDIA.....</b>	<b>42</b>
<b>BOTIME.....</b>	<b>46</b>
<b>VIZIONI I SË ARDHMES.....</b>	<b>50</b>
<b>TRANSPARENCA DHE PASQYRAT FINANCIARE.....</b>	<b>51</b>

## Mesazh nga Drejtuesja Ekzekutive

### VALBONA MAZREKU



Përkushtimi dhe puna me komunitetin kanë qenë në qendër të aktiviteteve tona në Milieucontact Shqipëri. Nisi në fillim të vitit 2000, me synim krijimin e një lëvizje mjedisore aktive dhe demokratike me ndikim të madh në shoqëri; e aftë të rrisë ndërgjegjësimin në publik dhe të luajë një rol të rëndësishëm në procesin e politikave dhe të vendimmarrjes në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Dhe, nuk u përqëndrua vetëm me organizatat mjedisore, por edhe me ato të shëndetit, grave, zhvillimit të komunitetit, etj., të cilat kishin në misionin e tyre mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Sot, puna e Milieucontact synon shërbimin ndaj shoqërisë drejt qëndrueshmërisë. E njëjta filozofi dhe parime qëndrojnë në projekte dhe shërbimet e ofruara, qofshin këto për komunitetet lokale, organizatat mjedisore partnere, njësisive të qeverisjes vendore apo aktorë të tjerë ndërkombëtar.

Sfidat e zhvillimit ekonomik të Shqipërisë në “kurriz” të mjedisit gjatë kësaj periudhe kanë qenë betejat e komunitetit të organizatave mjedisore dhe natyrshëm Milieucontact ka qenë pjesë aktive e lëvizjeve të shumta, jo vetëm lokale, por edhe atyre rajonale. Këtu mund të përmendim përpjekjet për të rregulluar dhe korrigjuar menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane (2013); përpjekjet për të rritur informimin e publikut në lidhje me çmontimin e armëve kimike në Shqipëri (2015); ndërmarrjen e nismave për mbrojtjen e

lumenjve, duke kërkuar rishikim të lejeve mjedisore dhe kushteve të tyre; Moratoriumi për hidrocentralet e vegjël dhe të mesëm, duke nisur nga HEC-et që ndërtohen në zonat e mbrojtura, si edhe në ato raste ku ka pasur konflikte të mëdha me komunitetin (2015-2017).

Mbi të gjitha Milieucontact Shqipëri ka dhënë një kontribut të madh në fuqizimin e zbatimit të legjislacionit horizontal, ku qasja e komunitetit në informacionin mjedisor dhe në vendimmarrjen mjedisore janë elementë të përhershëm në programet dhe projektet e Milieucontact. Së fundmi janë shfaqur edhe rastet e para të ushtrimit të së drejtës për t’iu drejtuar gjyqësorit për çështjet e mjedisit.

Paketë e rëndësishme e Milieucontact ka qenë konsulenca në përjasjen gjinore dhe vlerësimin e politikave/programeve të bashkive mbi shërbimet sociale dhe buxhetimin, duke siguruar rekomandime për përmirësim e ndryshim të tyre.

Ndërkohë, paketa e fundit e MiA-s është puna në fushën e energjisë; mbështetja dhe nxitja e burimeve të rinovueshme kryesisht në pjesën jugore të vendit, por jo vetëm. Koncepti i varfërisë energjikut dhe i komuniteteve të energjisë, ndonëse koncepte të reja në vendin tonë, zënë një vend të rëndësishëm në aktivitetet tona drejt gjithëpërfshirjes në tranzicionin e energjisë.

Së bashku me partnerët e saj, Milieucontact po punon për të realizuar synimet në veprime konkrete, ku mbështetja nga donatorë të ndryshëm na ka ndihmuar të konkretizojmë të gjitha angazhimet tona. Ne do të vazhdojmë punën për të realizuar me efektivitet aktivitetet dhe arritur rezultate të larta për një mjedis të qëndrueshëm.

*“Në një botë që shpesh sfidon shpresat tona, ne mund të sfidojmë më së miri zhvillimin e pakontrolluar me informim, përfshirje dhe alternativa miqësore me mjedisin”.*

## Angazhimi ynë kombëtar përkrah shoqërisë civile

‘Çdo gjë që është e çmuar është e pambrojtur’ ka thënë një poet holandez. Edhe organizatat e shoqërisë civile për mjedisin dhe natyrën janë me siguri të tilla. Vullneti politik dhe gatishmëria e qytetarëve për të kontribuar për çështjen janë faktorët kryesor, që mund të sjellin ndryshimin, sidomos atë të qëndrueshëm.

Është e padiskutueshme se qeveria ka nevojë për shoqërinë civile në dialogun me qytetarët. Në një demokraci pjesëmarrëse aktorët kyç janë të nevojshëm për të përfaqësuar qytetarët dhe ‘për t’u dhënë zë atyre që nuk kanë një zë’, si natyra dhe mjedisi. Së fundmi, kur gjërat dalin jashtë kontrollit për shkak të një politike jo të mirë apo veprimeve të papërgjegjshme të autoriteteve, individëve apo kompanive; cilësia e mjedisit, shëndeti i njerëzve dhe cilësia e jetës kërcënohet. Janë këto raste kur qytetarët organizohen për të mbrojtur mjedisin e tyre.

Në këtë kontekst Milieukontakt (MiA) ka luajtur një rol tepër aktiv në çështje dhe fushata të ndryshme të ndërmarra nga shoqëria civile, për mbrojtjen e burimeve natyrore nga tjetërsimi, duke i thënë ndal shkatërrimit, ndotjes, apo politikave aspak miqësore me mjedisin. Sa më sipër janë fushata të vogla apo veprime të shkëputura në kohë të organizatave të shoqërisë civile, por kanë qenë të kordinuara mes nesh si dhe janë mbështetur nga faktor ndërkombëtar, duke i ngritur këto çështje në axhendat e komisioneve të BE-së apo edhe të forumeve teknike. E veçanta e këtij bashkëpunimi ka qenë sinergjia e krijuar nga ekspertiza e brendshme (përmes studimeve dhe raporteve të plota teknike) dhe veprimeve advokuese mbështetur edhe nga faktori ndërkombëtar. Zëri i shoqatave ka arritur të përcillet jo vetëm pranë ministrisë përkatëse, por edhe në Komisionin Parlamentar të Veprimtarisë Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit apo edhe në tryeza pune me aktorë ndërkombëtar, duke tërhequr vëmendjen për zhvillimin e pakontrolluar veçanërisht në sektorin e energjisë.

Ky zë ka ndikuar në identifikimin e nevojës së realizimit të vlerësimit strategjik mjedisor për HEC-et e vegjël dhe të mesëm, si dhe ka qenë një burim i mirë referues për Strategjinë Sektoriale të Energjisë.

Angazhimi i MiA-s për të mbështetur zhvillimin e rrjetëzimit është përshkruar gjerësisht në libërthin “Lëvizja Mjedimore nën kontekstin Evropian”. Rrjetëzimi mund të përshkruhet si një shkëmbim horizontal, ku informacioni kordinohet, mbështetet dhe shpërndahet, por jo të kontrollohet. Rrjetëzimi është një strukturë shumë e rëndësishme, e cila kërkon mbështetjen dhe respektin e të gjithë aktorëve të saj.

Një lëvizje mjedimore është e suksesshme kur përveç profesionalizmit, ndjesive dhe perceptimeve individuale, ka gjithashtu edhe mbështetje financiare. Në vendet e zhvilluara lëvizjet e ndryshme mjedimore fillimisht u mbështetën financiarisht nga aktor privat, mbështetje e cila u pasua më vonë nga qeveritë përkatëse (p.sh rasti i Hollandës). Në më të shumtën e rasteve organizatat e shoqërisë civile financohen nga donator të huaj, apo anëtarësime individuale ose mbështetje tepër e vogël nga qeverisja lokale dhe kombëtare.

“Kemi punuar dhe do të vazhdojmë të punojmë çdo ditë, që të jetojmë në një botë më të mirë se ajo që gjetëm. E dimë, kemi një rrugë të gjatë përpara si dhe shumë punë për të bërë. Por, ne jemi të angazhuar si dhe mirëpresim të gjithë vullnetarët, për t’u bërë pjesë e rrugëtimit tonë”.



## Angazhimi ynë ndërkombëtar

Çështjet e ndryshme mjedisore, me problematikat dhe rrisqet e tyre janë çështje të cilat kërkojnë bashkëpunim dhe vëmendje jo vetëm kombëtare, por edhe ndërkombëtare. Në vitet 2000-2010, por edhe më tej projektet e Milieukontakt kanë patur karakter rajonal duke mbuluar disa shtete fqinj si Maqedonia, Mali i Zi, Kosova, Bosnja, Serbia apo dhe rajonin e vendeve të ish Bashkimit Sovjetik. Këta projekte kishin një komponent mjaft të fortë bashkëpunimi dhe ndarje eksperiencash mes organizatave të ndryshme, duke ndërtuar dhe përfituar nga mësimet e nxëna. Indirekt kjo i forcoi gjithnjë e më shumë pozitën e këtyre organizatave dhe i bëri pjesë të tavolinave të punës së mjaft nismave mjedisore ndërkombëtare. Për një të ardhme të qëndrueshme ballkanike, Milieukontakt ka realizuar dhe zhvilluar Axhendën e Gjelbër, duke zhvilluar kështu një metodë të re pjesëmarrje të përfaqësuesve të sektorëve të ndryshëm, për zhvillimin dhe zbatimin e strategjive lokale të zhvillimit të qëndrueshëm bazuar në vlerat natyrore, kulturore dhe turistike.


Në vitet në vazhdim Milieukontakt ka bashkëpunuar me autoritetet lokale të administratës së decentralizuar të Epirit dhe Maqedonisë Perëndimore, rajoni i ishujve Jonian dhe Këshillin e Qarkut Vlorë. Milieukontakt arriti në vendosjen e një bashkëpunimi në nivel të lartë midis dy vendeve për adresimin e rrezikut nga eutrofikimi i ujërave bregdetare dhe mbrojtjen e mjedisit.

Milieukontakt Shqipëri si partnere në projektin EmpowerMed (Horizon 2020) adreson së bashku me partnerët e tjerë (7 shtete) sfidën e varfërisë energjitike në zonën e Mesdheut, me fokus të veçantë përfshirjen dhe fuqizimin e grave përgjatë fushatave të pilotimit në 6 zona, një prej këtyre zonave është edhe Bashkia e Vlorës.

Milieukontakt është pjesë aktive e disa rrjeteve ndërkombëtare që operojnë në fushat e zhvillimit të qëndrueshëm, mbrojtjes së lumenjve, pesticideve, barazisë gjinore, etj (si WECF, IHPN, GAIA, YEE) dhe së bashku me to ngre problematikat mjedisore në nivelet e larta të vendimmarrjes evropiane si dhe advokon për një zbatim më të drejtë të Direktivave Evropiane edhe në Shqipëri.

### NDIKIMI NË SHIFRA

- Qytetarët 6241
- Nxënës dhe studentë 4000
- Mësuesit 102
- Bashkëpunëtorët 55
- Bashkitë 51
- Donatorët 32
- Projektet e zbatuar 32
- Ekspertët 28
- Botimet 15



## ZHVILLIMI I QENDRUESHËM



Sektori A



## Projektet e zhvilluara përgjatë viteve 2015-2020

### A. Zhvillimi i Qëndrueshëm



Korrik 2013 – Qershor 2015 “Shanse të përfshirjes social-ekonomike të grave”

Grupi kryesor i përfshirë përgjatë projektit ka qenë gratë dhe të rinjtë e papunë në zonat rurale, duke iu ofruar mundësi të reja të përfshirjes social-ekonomike (RISE-OP). Përgjatë zbatimit të projektit dy vjeçar grupet e synuara rritën aftësitë dhe njohuritë e tyre përmes kurseve profesionale. Duke përmirësuar aftësitë e tyre tanimë ata janë të gatshëm për krijimin e sipërmarrjeve të reja në sektorin e artizanatit dhe turizmit. Sipërmarrjet e reja dhe ato ekzistuese rritën dhe përmirësuan marketimin në gjithë territorin e Përmetit, përmes përdorimit të mjeteve që ofron media sociale në përgjithësi. Praktikrat dhe mësimet e një numri të konsiderueshëm të grave dhe të rinjve të papunë u tejçuan e promovuan në nivel vendor e kombëtar.

*“Projekti ishte fillim i një rruge të re për të gjithë përfituesit, duke zgjuar interesin e tyre dhe përdorur mundësitë për të promovuar Përmetin si një destinacion me potencial zhvillimi dhe atraksione turistike” (Gilberto Jaçe, ish Kryetari i Bashkisë Përmet)*



### Rezultatet:

01

Rritja e aftësive të 89 grave rurale dhe të rinjve të papunë në rrethin e Përmetit në artizanate dhe shërbime turistike.

02

Përmirësimi i kushteve ekonomike të 100 grave rurale dhe të rinjve të papunë nëpërmjet sipërmarrjeve të reja.

03

183 nxënës të shkollave 9-vjeçare ndoqën kurse artizanale si pjesë e shtuar e kurrikulës shkollore.

04


Krijimi i 22 sipërmarrjeve të reja në Bashkinë e Përmetit.

Aktorët	Partnerët	Donatori
Gratë, të rinjtë dhe sipërmarrjet e Pro Përmetit nga bashkia Përmet dhe Këlcyre	Bashkia Përmet Milieukontakt Shqipëri, Cesvi Përmet	IADSA Programi i Bashkëpunimit dhe Zhvillimit Italo-Shqiptar



Mekanizmat e bashkëpunimit mes OSHC-ve dhe Qeverisë për ofrimin e mendimit profesional e qytetar për çështje që shqetësojnë dhe kanë ndikim në jetën e publikut janë shumë të rëndësishme, si dhe kërkojnë vëmendjen e duhur. Një bashkëpunim i tillë është krijuar përgjatë projektit, ku OSHC-të mundësuan një model pozicionimi për HEC-et e vegjël, duke adresuar problematika, të cilat kanë një ndikim të madh në mjedis. Nëpërmjet këtij modeli janë adresuar problematikat e HEC-eve në nivel kombëtar, si dhe është lobuar në qeveri, për rishikimin e lejeve egzistuese

dhe vendosjen e një moratoriumi në ndërtimin e HEC-eve për një periudhe 3 vjeçare.



*“Ndërtimi i HEC-eve të vegjël ka ndikuar në krijimin e kostove ekonomike dhe sociale për komunitetet lokale; siç është mungesa e ujit për konsumet bazë, duke prekur në mënyrë të drejtpërdrejtë sektorin e bujqësisë dhe turizimit. Në kontekstin mjedisor ka ndikuar në peizazhin estetik, megjithatë ende mungon një vlerësim për humbjet e biodiversitetit, larmishmërisë biologjike etj”*

*(Spase Shumka, ekspert mjedisi)*

## Rezultatet:

**01**

Analizë e ndikimit mjedisor, social dhe ekonomik që kanë HEC-et e vegjël.

**02**

Analizë të kuadrit institucional dhe rregullator ekzistues.

**03**

Analizë e situatës dhe tendencat e zhvillimit të kërkesës për energji.

Aktorët	Partnerët	Donatori
Shoqëria Civile, insitucionet, ekspertë	Milieukontakt Shqipëri, Qendra EPER	REC Shqipëri





Qytetarë dhe institucione lokale në 7 qytete të Shqipërisë (Tirana, Elbasani, Gramshi, Lezha, Kruja, Saranda, Përmeti) janë informuar rreth problematikave më të nxehta mjedisore. Qytetarët janë këshilluar të marrin pjesë në politikë-bërje për çështjet e mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Ata janë nxitur gjithashtu të llobojnë dhe kërkojnë nga përfaqësuesit e partive politike, që të adresojnë në programet e tyre zhvillimin e qëndrueshëm, duke i dhënë njëkohësisht zgjidhje problemeve mjedisore që ka komuniteti.



*“Nëse sfidat mjedisore nuk identifikohen saktë në nivel shteti, i cili nga ana tjetër duhet t’i zhvilloj në nivel sektorial dhe vendor, objektivat për mbrojtjen e mjedisit do të mbeten të pa zbatuara, duke krijuar kosto të mëdha ekonomike, sociale dhe politike për brezat e ardhshëm. Kosto të cilat në aspektin mjedisor në disa raste janë të parikuperueshme”*

(Prof. Arben Malaj)

### Rezultatet:

**01**

Adresimi i problematikave mjedisore në organet vendimmarrëse në 7 bashki.

**02**

Sensibilizimi i qytetarëve për çështjet e mjedisit dhe bërija transparente e programeve të partive politike, në rastet kur janë fokusuar tek mjedisi.

**03**

Përgatitja e studimit “Problematikat mjedisore në 7 qytete të Shqipërisë”.

**04**


Materiali lehtësues “Manual për Buxhetimin dhe Monitorimin e Politikave Mjedisore” për organizatat.

Aktorët	Partnerët	Donatori
OSHC-të mjedisore (7) institucione lokale (7) qytetarë, (1) ekspert i lartë i financës	Milieukontakt Shqipëri, rrjeti ECIM (7 partner)	Programi Senior II REC Shqiperi



Janar 2019 – Qershor 2019 “**Stanet e Shëngjergjit si destinacione ekoturistike**”

Përmirësimi i kushteve të jetesës në disa stane në Shëngjergj, për njerëzit që punojnë pranë tyre, duke lehtësuar punën ka qenë synimi kryesor i projekti. Stanet, tashmë të përmirësuar, mund të shihen si një mundësi e kalimit dhe përdorimit të tyre edhe si “shtëpi bujtëse”. Zona ofron burime dhe bukuri të shumta natyrore, ku turistë shqiptarë dhe të huaj (kryesisht të rinjë) i shfrytëzojnë këta stane thuajse gjatë gjithë vitit, duke bujtur përgjatë guidave të tyre të gjata në natyrë.



*“Investime të tilla na ndihmojnë jo vetëm ne, por edhe zonën, pasi turistët që vizitojnë zonën mund të ndalojnë dhe vizitojnë stanet tona. Të gjitha pajisjet që keni sjell na kanë hyrë shumë në punë”.*

*(Olsi Sula, banor në Shëngjergj)*

## Rezultatet:

**01**

Ndërtimi i një infrastrukture të re në tre stane duke mundësuar akomodim, ushqim, vend pushim dhe ngrënie, mundësi vendosje kampingu, banjo-dushe, mjedis përpunim bulmeti në kushte familjare dhe, vathë për bagëtitë. Ofrimi i kushteve më të mira për barinj të përmes investimeve në energji, ujë, kanalizime.

**02**

Prodhimi i një harte turistike dhe tabela informuese outdoor për Shëngjergjin, e integruar edhe në hartën turistike të Bashkisë së Tiranës (turizmi rural dhe kulturor) në shkallën 1:50.000 Harta mund të shfrytëzohet edhe si material promovimi për turistët.

**03**

Promovimi i investimit dhe burimeve natyrore dhe turistike në median sociale dhe televizion.

Aktorët	Partnerët	Donatori
Njësia Administrative Shëngjergj, Bashkia Tiranë, komuniteti	Milieukontakt Shqipëri	GEF, Programi i granteve të vogla



## Prill – Tetor 2018 “Dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore në Shqipëri”

Në 2018 u realizua dokumenti strategjik i pozicionimit të Organizatave të Shoqërisë Civile rreth dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore në Shqipëri; ku është vlerësuar situata e tyre për periudhën 2014-2017, nga ekspertët e fushës, duke marrë në konsideratë angazhimet e OSHC-ve, të cilat kanë në fokus të punës së tyre çështjet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe përballimin e fatkeqësive natyrore. Studimi ofron alternativa, opinione nga OSHC-të, ashtu edhe rekomandime mbi mundësitë e masat që duhen marrë në të ardhmen.



### Rezultatet:

**01**

Analizë nga ekspertët e fushës për fatkeqësitë e ndodhura në vitet e fundit; të dhëna statistikore mbi dëmet dhe popullsinë e prekur, veprave infrastrukturore të dëmtuara nga fatkeqësitë natyrore.

**02**

Analizë e komuniteteve të prekura, arsyet e prekshmërisë, vlerësimi i njohurive të tyre mbi rrezikun dhe riskun ndaj të cilit ekspozohen.

**03**

Vlerësim i kapaciteteve njerëzore në nivel prefekturë dhe bashkie për të përballuar fatkeqësitë natyrore.

**04**

Hartëzim në sistemin GIS i zonave të prekura, dëmeve të shkaktuara dhe popullsisë së prekur.

**05**

Vlerësim i nevojës për ndërhyrje dhe përmirësim të gjendjes. Rekomandime specifike për përmirësim

Aktorët	Partnerët	Donatori
OSHC-të mjedisore (7) institucione lokale (7) qytetarë, (1) ekspert i lartë i financës	Milieukontakt Shqipëri, rjeti ECIM (7 partner)	Programi Senior II REC Shqiperi



## Shkurt-Dhjetor 2019 “Zbatimi i Planit Strategjik të Qendrës së Vizitorëve Radhimë”

Projekti synoi të mbështesë funksionimin e Qendrës së Vizitorëve të parkut detar Karaburun-Sazan në Radhimë; të ndërgjegjësojë, informojë/edukojë komunitetet lokale dhe përdoruesit e Zonave të Mbrojtura Detare (ZMD), mbi vlerat dhe përfitimet, në të njëjtën kohë të rrisë angazhimin e tyre në menaxhimin e këtyre zonave.

Qendra e Vizitorëve të Zonës së Mbrojtur Detare Karaburun-Sazan në Radhimë hapi dyert e saj për publikun në nëntor të vitit 2017. Pranë saj funksionon Qendra e sapokrijuar për Shpëtimin dhe Rehabilitimin e Breshkave të Detit.

*“Nëse më parë speciet e breshkave dëmtoheshin apo lëndoheshin, sot ato dërgohen pranë qendrës së rikuperimit; ku vlerësohet se 70% e këtyre specieve gjendet në Gjirin e Vlorës”.*

**(Nexhip Hyslokaj, AdZm Vorë)**



### Rezultatet:

**01**

Ofruar ndihmë për administratën lokale; për të zbatuar planin e veprimit të saj, duke promovuar qendrën si një MAP e parë dhe për të ndërtuar përvojat më të mira që mund të përsëriten për pjesë të tjera të Shqipërisë.

**02**

Intensifikimi dhe forcimi i aktiviteteve të menaxhimit për K-CMPA që tregon se MCPA mund të mbrojë në mënyrë efektive biodiversitetin detar duke: i) Identifikuar aspektet kryesore të zbatimit të SPVC, ii) siguruar listën konkrete të veprimeve pilote të përshtatshme që do të zbatohen në bashkëpunim me organizatat vendore për zbatimin e funksioneve dhe qëllimeve të SPVC; iii) ngritur kapacitetet (trainimi dhe stërvitja në vendin e punës) të OJQ-ve lokale mbi biodiversitetin, menaxhimin e ekosistemit, dukshmërinë dhe ndërtimin e kapaciteteve.

**03**

Realizimi i 10 aktiviteteve promovuese për parkun kombëtar detar në partneritet me organizatat lokale në bashkinë Vlorë.

Aktorët	Partnerët	Donatori
AKZM, AdZm Vlorë, Bashkia Vlorë, organizatat lokale, shkollat e qytetit të Vlorës dhe Fierit, Universiteti i Vlorës	Milieukontakt Shqipëri	UNDP





## Tetor 2019- Qershor 2020 “Iniciativa për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm në Bashkinë Përmet”

Promovimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit në Bashkinë Përmet me fokus edukimin dhe ndërgjegjësimin e të rinjve në ruajtjen e mjedisit, ka qenë qëllimi kryesor i projektit. Një projekt i sukseshëm jo vetëm për produktet e realizuara, por edhe për angazhimin e komunitetit në zonë.

*“Bashkëpunimi ndërmjet dy organizatave (Vjosa Explorer dhe Milieukontakt) ka filluar disa vite më parë dhe vazhdon edhe sot me suksese dhe arritje në fushën e mjedisit. Milieukontakt është një organizatë e konsoliduar me staf profesional, të cilët punojnë me pasion dhe përgjegjshmëri. Unë do doja të falënderoja Milieukontakt për punën e mirë dhe të palodhur që bën për mbrojtjen e mjedisit në Shqipëri”. (Giorgio Ponti, Përmet)*



### Rezultatet:

**01**

Përmirësimi i cilësisë së informacionit turistik në Bashkinë Përmet për vizitorët dhe turistët vendas e ata të huaj.

**02**

Promovimi i Bashkisë Përmet si një destinacion turistik dhe i ofruesve të vegjël të shërbimeve turistike që aktualisht janë në hije.

**03**

Ndërgjegjësimi, edukimi dhe trajnimi i komunitetit në ruajtjen e mjedisit si një element i rëndësishëm në zhvillimin turistik të zonës.

**04**

Realizimi i një eventit periodik për të promovuar traditën, produktet tipike dhe gastronominë lokale si elementë të rëndësishëm të identitetit dhe atraktivitetit të zonës.

Aktorët	Partnerët	Donatori
Bashkia Përmet, komuniteti, të rinjë turistë	Milieukontakt Shqipëri, Vjosa Explorer	UNDP



1 shtator 2019 – 30 qershor 2020 “Përgatitja e të rinjëve në Shëngjergj si guida natyrore”

Milieukontakt Shqipëri në partneritet me Vjosa Explorer realizoi projektin në kuadër të nismës WEB4YES – Western Balkan Civil Society Organizations for Youth Employment Support, koordinuar nga Belgrade Open School, me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian.

Janë përgatitur të rinjtë e Shëngjergjit si guida natyrore, duke u aftësuar për të qenë guida natyrore si dhe për të hyrë e konkuruar në tregun e punës. Duke përmirësuar infrastrukturën turistike në zonë, përgjatë projektit të rinjëve të zonës i'u mundësuan praktikat dhe politikat evropiane në mbrojtjen e natyrës, ku vajza dhe djem krijuan eksperiencat personale, të cilat më pas mund t'u ofrohen turistëve të ndryshëm. Tashmë në zonë çdo turist shqiptar dhe i huaj mund t'i drejtohet këtyre guidave, për të përfituar nga shërbimi që ato ofrojnë. “Guida Shëngjergj” ofrojnë shërbime për të gjitha destinacionet turistike që ka zona e tyre.

*“Zona e Shëngjergjit ofron burime të shumta natyrore dhe bukuri, të cilat kanë nevojë të njihen. Përgatitja e të rinjëve profesionistë si guida natyrore, por jo vetëm, ndihmon në rritjen e të ardhurave financiare për familjet që jetojnë në zonë”.*

**(Ina Dorda Eksperte turizmi dhe komunikimi, Nj.A. Shëngjergj)**



### Rezultatet:

**01**

Trajnime për të rinjtë në zonë; shkëmbim eksperiencash, ku të rinjtë nga Përmeti ofruan eksperiencat e tyre të suksesshme si guida në zonën e tyre.

**02**

Krijimi i tri shtigjeve në zonën e Shëngjergjit, duke vendosur edhe tabelat përkatëse për çdo shteg.

**03**

Krijimi i hartës dixhitale të shtigjeve, më të dhënat e nevojshme për shtigjet e realizuar nga të rinjtë e zonës. Harta dixhitale është e publikuar online.

**04**

Promovimi i burimeve të zonës së Shëngjergjit në rrjetet sociale.

Aktorët	Partnerët	Donatori
Njësia Administrative Shëngjergj Shkolla e Mesme “Shëngjergj” Komuniteti	Vjosa Explorer, Milieukontakt Shqipëri,	Bashkimi Evropian përmes Belgrade Open School



2 Dhjetor 2019 – 31 Maj 2020 “Turizëm i qëndrueshëm dhe promovimi i produkteve agro-ushqimore në zonën e Anës së Malit”Përmet”

Ruajtja e vlerave ekologjike dhe kulturore në Njësinë Administrative Ana e Malit, Bashkia Shkodër, duke përmirësuar kushtet e infrastrukturës së jetesës së banorëve, me qëllim përshtatjen e tyre si shtëpi pritjeje, bazuar në përdorimin e qëndrueshëm të shërbimeve të turizmit lokal dhe atij ndërkuftar. Aktivitetet e projektit janë zbatuar në Njësitë Bashkiake, Ana e Malit dhe Rrethina, pjesë e zonës qendrore të peisazhit ujor/tokësor i mbrojtur i lumit Buna. 4 familje kanë përfituar mbështetje për përmirësimin e banesave të tyre dhe ngritje kapacitetesh, promovim për kthimin e shtëpive ku ata jetojnë si shtëpi pritje (guest house). Fermerët e zonës u pajisën me amballazhe dhe etiketa për produktet e tyre.

*“Mbështetje të tilla na japin mundësinë të promovojmë produktet dhe shërbimet turistike që ofron zona, duke nxitur promovimin dhe zhvillimin e eko-turizmit” (Arben Ceni, Administrator NjA Ana e Malit)*



### Rezultatet:

**01**

Etiketimi i unifikuar i prodhimeve bujqësore të zonës.

**02**

Organizimi i dy panaireve agro-ushqimore, promovim i prodhimeve vendase, duke ndihmuar fermerët të tregojnë prodhimet e tyre edhe në të ardhmen.

**03**

Përshtatja e katër (4) shtëpive në zonë si shtëpi pritje, duke mos tjetërsuar pejzazhin në terësi dhe origjinalitetin e shtëpive në veçanti.

**04**

Përmirësimi i nivelit socio-ekonomik të banorëve në zonë.

Aktorët	Partnerët	Donatori
Njësia Administrative Ana e Malit Bashkia Shkodër, Komuniteti, Turistët në zonë	Green Center Milieukontakt Shqipëri,	PAP/RAC, permes INCA Shqipëri

## INTEGRIMI NË BE

### Sektor B





## B. Integrimi në BE



Shtator 2014 – 2016

(IPA GREQI-SHQIPËRI) “Rrjeti i monitorimit të rrezikut të eutrofikimit të ujërave detare”

Rrjeti Satelitor i Monitorimit vendosi bashkëpunimin në nivel të lartë mes Shqipërisë dhe Greqisë, në drejtim të marrëdhënieve bilaterale, për gjetjen e zgjidhjeve për problemet e përbashkëta. Përgjatë zbatimit të projektit u zbatua një plan i koordinuar për mbrojtjen e mjedisit, duke adresuar problemin e përbashkët të rrezikut të eutrofikimit mbi të gjitha ujërat detare bregdetare të zonës përfituese të programit IPA CBC. Grupi i punës ndihmojë autoritetet përgjegjëse të jenë në përputhje me direktivat e BE-së dhe legjislacionin kombëtar. Përdorimi i teknologjisë për vëzhgimin e Tokës dhe TIK, ndihmojë në integrimin në punën e përditshme të Administratës Publike. Projekti bëri të mundur gjithashtu integrimin e njohuri shkencore specifike në zgjidhjen e problemit të përbashkët mjedisor për të dy vendet. Ndërgjegjësimi i publikut për nevojën e mbrojtjes së ujërave bregdetare ishte një tjetër aktivitet i realizuar në zonën ndërkufitare Shqipëri-Greqi.



### Rezultatet:

01

Zbatimi i Direktivës Kuadër të Ujit dhe asaj INSPIRE nga institucionet shumë palëshe.

02

Monitorimi statelitor i ujërave detare dhe analizimi përmes kampioneve të marrë në zona të ndryshme të bregdetit të Jugut të Shqipërisë.

03

Të dhëna në kohë reale për cilësinë e ujërave bregdetare.

04

Adresimi i problemeve konkrete dhe marrja e masave në lidhje me eutrofikimin e ujërave.

Aktorët	Partnerët	Donatori
Ekspertë dhe OJF mjedisore, MBUZHR, Ministria e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit	Milieukontakt Shqipëri, Qarku Vlore, Drejtoria e Ujrave të Epirit, Rajoni i Ishujve Jonian	Bashkimi Europian përmes IPA CBC

## QEVERISJE DHE NDËRTIM KAPACITETESH



Sektor C

## C. Qeverisje demokratike dhe ndërtim kapacitetesh



2016 – 2017 “Plani i menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Shijak”

Është hartuar plani vendor në Bashkinë Shijak për menaxhimin e mbetjeve, duke u bazuar dhe marrë në konsideratë kushtet e Bashkisë. Është zbatuar Strategjia Kombëtare dhe objektivat e Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve. Element shumë i rëndësishëm ishte edhe ngritja e kapaciteteve të stafit të bashkisë dhe këshillit në lidhje me menaxhimin e integruar të mbetjeve.

Plani vendor i menaxhimit të mbetjeve synon mes të tjerave mbulimin me shërbimin e mbledhjes dhe transportit të mbetjeve nga i gjithë territori i Bashkisë, pra shërbimi u shtri në të katër Njësitë Administrative: Shijak, Xhafzotaj, Maminas dhe Gjepalaj.



### Rezultatet:

**01**

Hartimi i planit vendor për menaxhimin e mbetjeve.

**02**

Ngritja e kapaciteteve të stafit të Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak.

**03**

Ndërgjegjësimi i komunitetit mbi shërbimin e ofruar.

**04**

Investim për blerjen e 340 kontenierëve.

Aktorët	Partnerët	Donatori
Stafi Administrativ Bashkia Shijak Këshillit Bashkiak Komuniteti	Milieukontakt Shqipëri	HELVETAS Swiss Intercooperation permes programit DLDP



Janar – Shkurt 2019 “Diagnoza mbi menaxhimin e mbetjeve të ngurta urbane në Qarkun e Elbasanit”

Ekipi i ekspertëve për menaxhimin e mbetjeve, pranë Milieukontakt ka kryer një diagnozë të situatës aktuale dhe zhvilluar një bazë të dhënash që do të ndihmojë për përgatitjen e planeve të reja lokale të menaxhimit të mbetjeve për 6 bashkitë, e qarkut të Elbasanit, si dhe ka përgatitur modelin / skemën teknike dhe institucionale për aktivitetet e menaxhimit rajonal të mbeturinave bazuar dhe në propozimin e Masterplanit kombëtar.




**Rezultatet:**

**01**

Të dhëna bazë dhe të përgjithshme mbi menaxhimin e mbetjeve.

**02**

Prioritetet për planifikim dhe veprime afatshkurtra.




Aktorët	Partnerët	Donatori
Bashkia Elbasan, Cërrik, Gramsh, Përrenjas, Belsh Librazhd	Milieukontakt Shqipëri	HELVETAS Swiss Intercooperation, Programi Bashki të Forta





## Janar – Shkurt 2019 “Plani Operacional për Bashkitë Patos dhe Roskovec”

Plani ka ndihmuar në rritjen e njohurive dhe aftësive të përfaqësuesve të organizatave / bashkive për të udhëhequr dhe menaxhuar organizmat të cilat përfaqësojnë. Rregullorja e hartuar ka për objekt krijimin e një kuadri rregullator për funksionimin me efikasitet dhe efikasitet të veprimtarisë së administratës së Bashkisë, si dhe përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e stafit të saj dhe, mënyrën e bashkëveprimit të organeve të Bashkisë ndërmjet tyre me të tretët, për realizimin e funksioneve dhe kompetencave të saj të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.



### Rezultatet:

**01**

Rritja e kapacitetit të stafit të Bashkisë në procesin e transparencës dhe llogaridhënies; çdo drejtorie ju bë me dije rëndësia e transparencës ndaj qytetarëve, raportimi në formën e duhur për çdo produkt në faqen e internetit të Bashkisë dhe zbatimi funksional i mekanizmave të dhëna nga ligji (Takimet publike, E Drejta e Informacionit dhe Komisioni i përhershëm brenda Bashkisë).

**02**

Përmes procesit pjesëmarrës, ku çdo specialist gjeneroj të dhënat e nevojshme. 25-30 specialistë janë përfshirë në procesin e hartimit të manualit operacional në secilën bashki.

**03**


Përmirësimi i komunikimit të brendshëm dhe koordinimit mes sektorëve. Përgjatë gjithë procesit stafi ka bashkëpunuar dhe dialoguar, për të vënë idetë në praktikë.

Aktorët	Partnerët	Donatori
Bashkia Roskovec Bashkia Patos	Milieukontakt Shqipëri	USAID përmes Projektit Zhvillimi dhe bashkëpunimi i përsheptuar i Shoqërisë Civile



## Prill – qershor 2019 “Hartimi i Planit të Menaxhimi të Mbetjeve Urbane, Bashkia Tepelenë”

Është ofruar mbështetje teknike për rritjen e aftësive dhe njohurive të stafit të Bashkisë Tepelenë, për të kryer sa më mirë një nga funksionet e saj; ofrimi i një shërbimi të lartë e cilësor për qytetarët. Ky plan ishte i pari dhe i vetmi Plan menaxhimi për mbetjet urbane të hartuar për bashkinë Tepelenë.



### Rezultatet:

**01**

Rritje e kapaciteteve të stafit të bashkisë në funksionin e menaxhimit të mbetjeve urbane.

**02**

Përmirësimi i performancës së bashkisë në lidhje me mbledhjen dhe menaxhimin e mbetjeve.

**03**

Politika zhvillimi lokal më të mira, që integrojnë zhvillimin e territorit (zonat urbane dhe rurale të Bashkisë).

Aktorët	Partnerët	Donatori
Bashkia Tepelenë	Milieukontakt Shqipëri	USAID përmes Projektit Zhvillimi dhe bashkëpunimi i përshpejtuar i Shoqërisë Civile



## Maj-qershor 2019 “Vlerësimi i Riskut në Menaxhimin e Financave të Bashkisë Përmet”

Është ofruar mbështetje teknike për rritjen e aftësive dhe njohurive të stafit të Bashkisë Përmet për menaxhimin financiar. Kjo më pas do të ndihmojë në përmirësimin e performancën së saj, për t'i shërbyer në kohë dhe me integritet qytetarëve. Kjo Strategji u finalizua mbas një analize studimore, trajnimit dhe vlerësimit të Riskut në Menaxhimin e Financave nga punonjësit e strukturave drejtuese të Bashkisë Përmet.

Ky dokument përcakton parimet e përgjithshme të menaxhimit të riskut dhe është ndërtuar si pjesë e pandarë me Strategjinë e Zhvillimit Vendor për Bashkinë Përmet duke menaxhuar risqet në vendimmarrje, vendosjen dhe arritjen e objektivave dhe përmirësimin e performancës në shërbim të komunitetit.

Dokumenti përcakton standartet që duhen përdorur në procesin e kontrollit të shërbimeve vendore me qëllim që të arrihet një përdorim më eficient i burimeve dhe rezultate sa më optimale në kontrollin e zbatimit të kuadrit ligjor të menaxhimit financiar.



### Rezultatet:

**01**

Rritje e kapaciteteve të stafit të bashkisë në funksionin e menaxhimit të riskut financiar.

**02**

Përmirësimi i performancës së bashkisë në lidhje me parashikimin dhe adresimin e riskut.

**03**

Hartimi i Strategjisë “Vlerësimi i Riskut në Menaxhimin e Financave të Bashkisë Përmet”.

Aktorët	Partnerët	Donatori
Bashkia Përmet Administrata e Bashkisë	Milieukontakt Shqipëri	USAID përmes Projektit Zhvillimi dhe bashkëpunimi i përsheptuar i Shoqërisë Civile



Projekti ndihmoi në formulimin dhe zbatimin e planit të administrimit të mbetjeve në 5 bashki, sipas standardeve kombëtare. Në hartimin e planit në çdo bashki është synuar që ai të jetë realist përsa i përket administrimit të mbetjeve, bazuar në një vizion të qartë e të përballeshëm nga çdo bashki. Në çdo plan një fokus të veçantë ka pasur integrimi në përfshirjen sociale dhe lehtësimin e integritit edhe të sektorit privat.

*“Ishte hera e parë që punuam për përgatitjen e një plani lokal, ku Milieukontakt luajti rol lehtësues dhe trajnues, duke ofruar një proces pozitiv dhe profesional. Përvoja brenda grupit të punës ishte shumë interesante, ndërsa përvoja ndër rajonale ishte e frytshme. Duke qenë të ekspozuar ndaj politikave të bashkive të tjera, ne patëm mundësinë të zgjedhim atë lloj metodologjie që është afër situatës sonë”.*

**(Ergita Kaso, nënkryetare e Bashkisë Gramsh)**



### Rezultatet:

**01**

5 plane të reja vendore të menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe llogaritja e kostove të shërbimit bazuar në legjislacionin dhe standardet e kërkuara.

**02**

5 rregullore të reja për administrimin e mbetjeve.

Aktorët	Partnerët	Donatori
Bashkia Elbasan, Gramsh, Prrrenjas Librazhd, Belsh	Milieukontakt Shqipëri	HELVETAS Swiss Intercooperation, Programi Bashki te Forta

## MJEDISI DHE SHËNDETI

### Sektori D





## D. Mjedisi dhe shëndeti



Tetor 2016 – Mars 2017 “Shkolla që dua”

Projekti është zhvilluar në shkollën 9-vjeçare “Kongresi i Lushnjes”. Përgjatë tij janë krijuar kushtet e nevojshme për zhvillimin e një procesi më të mirë arsimor bashkëkohor, duke nxitur, shkëmbyer dhe shpërndarë praktikat më të mira përmes vënies së theksit në mësimin praktik.”



### Rezultatet:

**01**

Një shkollë me standarde dhe mjedise mësimore të kohëve të fundit. Përmirësimi i infrastrukturës sportive, ndriçim eficient në shkollë, kushte higjeno-sanitare të reabilituara.

**02**

Nxënës aktiv, krijues dhe më të përqëndruar në orët e mësimit.

**03**

Garantimi i cilësisë së lartë të shëndetit të nxënësve.

**04**

Kordinim më i mirë ndërmjet prindërve dhe mësuesve për arritjen e objektivave të vitit akademik.

Aktorët	Partnerët	Donatori
Bashkia Tiranë Drejtorja e shkollës Komuniteti i nxënësve Komuniteti i prindërve	Milieukontakt Shqipëri	Philippe Morris



## Dhjetor 2017 – Qershor 2018 ”Edukimi për të gjithë”

Përmes zbatimit të projektit u përmirësuan kushtet në mjediset e shkollës së mesme “Sami Frashëri”, duke ofruar kushte për zhvillimin e një procesi më të mirë arsimor, duke bërë të mundur ndërtimin e një fushe sportive bashkëkohore. Shkolla u pajis me materiale didaktike për laboratorët e kimisë dhe biologjisë. Investimet e kryera në shkollë nxitën shkëmbimin dhe shpërndarjen e praktikave më të mira në mësimin praktik dhe atë teorik. Nxënësit e shkollës me dëshirë janë angazhuar gjithashtu në aktivitete të cilat kanë lidhje të drejtpërdrejtë me mjedisin, si dhe ndikojnë në ruajtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të tij.

*“Mbështetja ndaj arsimit dhe shkencës është thelbësore për Philip Morris. Ndaj dhe jemi shumë të gëzuar që mbështetëm rinovimin e kësaj shkolle, duke ditur që kushte më të mira dhe më bashkëkohore, motivojnë për rezultate më të mira në edukim dhe në shërbim të komunitetit. Në të ardhmen e afërt, ne synojmë të shkojmë një hap më tej dhe të intensifikojmë mbështetjen tonë direkte për shkencën në Shqipëri. Kjo është një fushë ku ne besojmë që kontributi ynë mund të ketë ndikim real për brezat që do të vijnë”*

*(Radmilo Vlacic, Philip Morris)*



### Rezultatet:

**01**

Një shkollë me mjedisë mësimore me standarde të kënaqshme. Përmirësim i infrastrukturës sportive, ndriçim i duhur në shkollë, kushte laboratorike të reja për zhvillimin normal të orëve eksperimentale.

**02**

Nxënës aktiv, krijues dhe më të përqëndruar në orët e mësimin.

**03**

Garantimi i cilësisë së lartë të shëndetit të nxënësve.

**04**

Kordinim më i mirë ndërmjet prindërve dhe mësuesve për arritjen e objektivave të vitit akademik

Aktorët	Partnerët	Donatori
Nxënësit e shkollës “Sami Frashëri”, komuniteti i prindërve, drejtoria dhe mësuesit e shkollës, Bashkia Tiranë	Milieukontakt Shqipëri	Philip Morris



Sensibilizimi e angazhimi i të rinjëve në përmirësimin e procesit të menaxhimit të mbetjeve urbane dhe shtimin e hapësirave të gjelbëra. Grupi i synuar në projekt ishin të rinjtë, si fillesë dhe pjesë shumë e rëndësishëm e komuniteteve në të cilët jetojnë. Projekti u zhvillua e zbatua në qytetin e Krujës dhe të Lezhës, me përfshirjen aktive të drejtorive dhe nxënësve të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme të të dy qyteteve.

*"Qyteti i Lezhës është i pastër, por sërish ndihet nevoja për projekte të tilla, të cilat ndihmojnë institucionet për të lehtësuar punën e tyre, ashtu edhe komunitetin, duke e informuar dhe krijuar lehtësira në infrastrukturë".  
(Jak Gjini, Ekspert mjedisi)*



### Rezultatet:

**01**

Orë mësimi, me njohuri dhe praktika konkret për edukimin mjedisor në shkolla

**02**

100 broshura për menaxhimin e mbetjeve.

**03**

Mbjelljen e 35 pemëve në mjediset e shkollave dhe një mjedisi të përbashkët, pranë një hapësire në qytetin e Krujës.

**04**

Pajisjen e 4 shkollave me kosha për diferencimin e mbetjeve, ku 21 kosha u shpërndanë sipas nevojave të shkollave.

**05**

Dy (2) video për menaxhimin e mbetjeve në qytetin e Lezhës dhe Krujës; videot janë përgatitur nga vetë nxënësit.

**06**

Me pjesëmarrjen e bashkive të të dy qyteteve, mësuesëve dhe nxënësve janë realizuar 2 aktiviteteve pastrimi, në zonat problematike.

Aktorët	Partnerët	Donatori
Nxënësit dhe stafi pedagogjik i 4 shkollave në Lezhë dhe Krujë, Bashkitë e dy qyteteve, komuniteti	Milieukontakt Shqipëri	Agjensia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile



## Shkurt 2018 – Janar 2019 “Menaxhimi i mbetjeve urbane në bashkitë Krujë, Përmet dhe Sarandë”

Monitorimi dhe vlerësimi i shërbimit të menaxhimit të mbetjeve urbane në bashkitë Krujë, Përmet, Sarandë, ishte procesi i zhvilluar së bashku me organizata lokale të tre qyteteve. Të dhënat e gjeneruara nga procesi i monitorimit, më pas u adresuan edhe tek bashkitë përkatëse në tre qytetet. Duke adresuar problematikat kryesore dhe dhënë rekomandimet e nevojshme, ky projekt nxori në pah pikat e forta dhe ato të dobëta në menaxhimin e mbetjeve në tre bashkitë respektive, duke çuar në përmirësimin e gjendjes aktuale të shërbimit të pastrimit në 3 bashki dhe ndërgjegjësuar qytetarëve për mbajtjen pastër të qyteteve ku ata jetojnë.

*“Për të ardhur keq është fakti se për vendosjen e kontenierëve dhe koshave të mbeturinave, askush nga firma e pastrimit dhe Bashkia, nuk ka marrë mendimin e banorëve, të cilët paguajnë një taksë pastrimi dhe duhet t’u shërbehet më së miri”.*

*(Vasilika Ifandi, AJMMI Sarandë)*



### Rezultatet:

**01**

Ngritja e kapaciteteve monitoruese të tre organizatave lokale lidhur me menaxhimin e mbetjeve.

**02**

Raport monitorimi mbi gjendjen e menaxhimit të mbetjeve në të tre bashkitë dhe rekomandime përkatëse për secilën bashki.

**03**

Mbi 1000 qytetarë të informuar dhe të ndërgjegjësuar për mbrojtjen e mjedisit, ruajtjen dhe përmirësimin e tij.

**04**

Cilësi më e mirë e shërbimit të pastrimit për 3 bashki (Krujë, Sarandë, Përmet).

Aktorët	Partnerët	Donatori
Organizatata lokale, bashkitë, komuniteti në Krujë, Sarandë, Përmet	Milieukontakt Shqipëri, Klubi Ekologjik Krujë, AJMMI Sarandë, Cesvi Përmet	Lëviz Albania



Prill 2018 - Prill 2021 “Mushkëri të gjelbra për qytetet tona”

### “Mushkëri të gjelbra për qytetet tona”

Krijimi i një platforme alternative të monitorimit në mjedis mbi cilësinë e ajrit, nivelin e zhurmave dhe vlerësimin e shërbimeve në ekosistem nga gjelbërimi urban në qytetin e Tiranës, Durrësit, Elbasanit dhe Shkodrës. Projekti adreson në mënyrë indikative por edhe sasiore ndotjen e ajrit, nivelin e zhurmave në zonat urbane si edhe reduktimin e gjelberimit urban. Raportet e ndryshme evidentojnë dhe lidhin ngushtesisht këto tre komponente si kontribuesit kryesor të cilët përcaktojnë cilësinë e jetes dhe shëndetit publik në qytetet tona.

*“Ka shumë kriza globale, me të cilat duhet të përballemi. Shpresoj që kjo t’i bëjë njerëzit të mendojnë: po sikur të kishim këtë cilësi të mirë të ajrit, jo sepse të gjithë janë të detyruar të rrinë në shtëpi, por sepse ne menaxhojmë ndryshimin për të rregulluar transportin dhe energjinë”.*

(Aurora Dibra, Eksperte mjedisi)



#### Rezultatet:

**01**

Krijimi i një metodologjie monitorimi alternative të unifikuar dhe gjithëpërfshirëse.

**02**

Krijimi i një platforme Open-Source WEB & GIS nëpërmjet të cilës do të raportohen dhe publikohen të dhënat e gjeneruara nga monitorimi për 4 Bashkitë e përzgjedhura.

**03**

Organizata dhe aktivistë aplikojnë në shkallë të gjerë metodologjinë e monitorimit alternativ, duke gjeneruar dhe ngarkuar të dhënat në platformën online.

Aktorët	Partnerët	Donatori
Shoqëria civile, institucione shtetërore, media, komuniteti	Milieukontakt Shqipëri, Co-Plan, Qendra EPER, Ekomjedisi, Qendra Aarhus Shkodër, Green Centre Shkodër, Klubi Ekologjik Elbasan	Bashkimi Evropian





## Shtator 2019 – Gusht 2023 “Fuqizimi i grave për të marrë veprime kundër varfërisë energjitike në Mesdhe”

Projekti punon për adresimin e sfidave të varfërisë energjitike në zonën e Mesdheut, me fokus të veçantë në përfshirjen dhe fuqizimin e grave. Në vendet e mesdheut, zonat bregdetare hasin një sërë sfidash në lidhje me varfërinë energjitike; ky fenomen haset gjithashtu edhe në banesa. Ndërtesat rrallë janë të izoluara, shpesh pa sistem ngrohje, ose jo efikas. Një element tjetër i varfërisë energjitike në këto zona lidhet edhe me ftohjen e banesave. Në përgjithësi është vërejtur se varfëria e energjitike prek në mënyrë disproporcionale gratë dhe familjet e drejtuara nga gratë, të cilat janë aktori më i rëndësishëm në luftën kundër varfërisë së energjisë. Projekti do të trajtojë specifikisht edhe ndikimin e varfërisë energjitike në shëndetin e njeriut. Ai do të kontribuojë në reduktimin e varfërisë energjitike në Mesdhe (përfshirë këtu edhe Shqipërinë) duke zbatuar një seri masash praktike për efikasitetin e energjisë dhe përdorimin e BRE me qëllim forcimin e familjeve në adresimin e varfërisë energjetike (në fokus gratë dhe shëndetin). Do të vlerësohen gjithashtu dhe masat e rekomandimet që mund të zbatohen në nivel politik, duke advokuar dhe adresuar politikat dhe masat për varfërinë energjitike tek aktorët në nivel lokal dhe në nivel Evropian.

### Rezultatet:

01

Krijojë rrjetin me aktorët lokal në zonën e Mesdheut (Vlorë – Shqipëri, Barcelonë – Spanjë, Marseille – Francë, Padova – Itali, Primorska – Slloveni, dhe Zadar – Kroaci) duke kaluar njohuritë e eksperiencave thelbësore për ngritjen e kapaciteteve të aktorëve të përfshirë në zbatimin e masave praktike.

02

Masa praktike, për të adresuar varfërinë energjitike (qasje në komunitet, vizita në banesa, mbështetje me investime të vogla, workshop për 60 individë nga personeli mjekësor në Bashkinë Vlorë.

03

Analizë mbi aktivitetet e zbatuara, ku rezultatet e përfutura do të jenë baza e rekomandimeve politike që do të hartohen. Partnerët e projektit dhe aktorët vendor do të advokojnë për promovimin e politikave që adresojnë varfërinë energjitike.



Aktorët	Partnerët	Donatori
Bashkia Vlorë Familje të prekura nga varfëria energjitike Gratë kryefamiljare të prekura nga varfëria energjitike Familje me probleme shëndetësore.	Milieukontakt Shqipëri, DOOR, SOGESCA, UAB, IREC, GERES, WECF, ESF koordinuar nga Focus.	Bashkimi Evropian, Programi Horizon 2020



Korrik – dhjetor 2019 “Mundësitë për trajtimin e paketimeve plastike në zinxhirin e vlerave ushqimore dhe pijeve”

Projekti synoi zvogëlimin e gjurmës plastike në sektorin e ushqimit dhe pijeve. Projekti angazhoi drejtpërdrejt palët e interesuara, për të identifikuar tendencat aktuale në përdorimin dhe asgjësimin e paketimeve plastike, politikave dhe vështirësive të tregut që prekin mundësitë për ridizenjimin, ripërdorimin ose riciklimin e paketimeve plastike, si dhe mundësinë e zbatimit të praktikave më të mira dhe risive. Pas fazës së parë të studimit me kompanitë, një numër i caktuar i kompanive të ushqimit dhe pijeve do të përfitojnë nga mbështetja teknike.



**Rezultatet:**

**01**

Hartëzim i rreth 50 kompanive që punojnë në sektorin e ushqimeve dhe pijeve mbi paketimet që ato përdorin.

**02**

Analizimi mbi situatën e paketimeve në zinxhirin e vlerave për sa i takon praktikave, strategjive dhe nevojave.

**03**

Informimi mbi mundësitë e bizneseve për të zgjidhur çështjen, duke marrë parasysh modelet më të suksesshme.

**04**

Mbështetje teknike për 3 kompanitë e interesuar.

**05**

Nxitja e angazhimeve vullnetare nga industria për të përmirësuar praktikën e paketimit.

Aktorët	Partnerët	Donatori
26 biznese, ekspertë, MTM, shoqatat e bizneseve	Milieukontakt Shqipëri	Qendra e Aktiviteteve për Konsumimin dhe Prodhimin e Qëndrueshëm e Kombeve të Bashkuara (SCP / RAC) dhe financuar nga BERZH



## Shtator – dhjetor 2019 “Menaxhimi i Ndotjes detare”

Projekti është mbështetur nga MedPol dhe konsistoi në: (i) inventarizimin e të dhënave të ndotjes detare sipas sistemit informative MED POL / MAPI për indikatorët 22 dhe 23; (b) përmirësimi dhe prezantimi i të dhënave socio-ekonomike specifike për të zbatuar masa për reduktimin e qeseve plastike dhe shisheve PET si dhe mbështetja e analizës socio-ekonomike.



Aktorët	Partnerët	Donatori
Ekspertë Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	Milieukontakt Shqipëri	MedPol



Projekt zbatuar nga Milieukontakt, me mbështetjen e GIZ dhe Bashkisë Lezhë për zbatimin e aktiviteteve pilot, nëpërmjet komunikimit, pjesëmarrjes dhe ndryshimit të sjelljes së qytetarëve, bizneseve, shkollave dhe aktorëve të tjerë për të parandaluar dhe reduktuar mbetjet plastike në Bashkinë Lezhë.

**Rezultatet:**

**01**

Projekte pilot të identifikuar, komunikimi dhe siguri i angazhimit të qytetarëve, bizneseve, shkollave dhe aktorëve të tjerë përkatës për parandalimin dhe reduktimin e mbetjeve plastike në Bashkinë Lezhë.

**02**

Reduktimi i mbeturinave të hedhura në trupa ujor dhe venddepozitimet ilegale nga qytetarët dhe bizneset pranë kanalit të Cenit dhe reduktimi i venddepozitimeve ilegale.

**03**

Qytetarët e Lezhës raportojnë pranë qendrës së komunikimit, ankohen dhe kërkojnë informacion mbi cilësinë e menaxhimit të mbetjeve.

**04**

130 biznese përfshihen në iniciativën “Zonë me plastik të reduktuar”.

**05**

Qytetarët përdorin kontenerët e veçantë për mbetjet plastike.

**06**

30 shkolla publike në bashkinë Lezhë përdorin setin me materiale edukuese gjatë orëve të hapura mësimore, për organizimin e konkursit dhe aktiviteteve të tjera demonstruese.

**07**

Qytetarët dhe turistët të ndërgjegjshëm për përdorimin e koshave specifike për depozitimin e bishtave të cigareve, duke mos i hedhur në bregdet dhe në shëtitoret kryesore.



*“Unë dhe stafi im kuptuam, se kërkohet një ndryshim fare i vogël në sjelljen tonë, nga i cili përfitojmë të gjithë, pra jo vetëm duke mos ju ofruar klientëve artikujt plastik me një përdorim, por edhe duke i inkurajuar e nxitur që të mos i përdorin ato, por t'i zëvendësojnë me artikuj miqësor me mjedisin”*  
**(Ernest Jushi, bar-restorant “Trevi” Lezhë)**

Aktorët	Partnerët	Donatori
Bashkia Lezhë Shkollat dhe nxënësit e qytetit Bizneset në zonë Komuniteti Turistët	Milieukontakt Shqipëri	GIZ Shqipëri



01.10.2020 – 30.09.2022 “Akademia e Energjisë për Qytetarët e Europës”

“Akademia e energjisë për qytetarët e Europës” ka për qëllim diversifikimin e lëvizjes së qytetarëve për energjinë në Evropë, duke u fokusuar në krijimin dhe transferimin e njohurive ndërmjet Evropës qendrore dhe asaj juglindore. Akademia do të ofrojë njohuri dhe mjete për ndërtimin e komuniteteve, zhvillimin dhe bashkëpunimin ndërmjet tyre. Praktikrat më të mira do të tregojnë si mund t'i tejkalojnë barrierat për energjinë e qytetarëve.

### Rezultatet:



**01**

Workshop dhe sesione trainimi do të realizohen në Shqipëri, Greqi dhe Gjermani.

**02**

Ngritjen e kapaciteteve në vendet e Evropës juglindore, duke ofruar njëkohësisht edhe eksperiencat për çdo vend.

**03**

Dy shkollat verore, do të risin bashkëpunimin ndërmjet vendeve të Evropës Juglindore ku komunitetet e energjisë sapo kanë nisur dhe, Evropës Qendrore që tashmë ka një traditë të këtyre komuniteteve, duke diversifikuar kështu komunitetet e energjisë ndërmjet shteteve.

**04**


Qasje gjithëpërfshirëse, duke angazhuar qytetarët e moshave, gjinive, niveli socio-ekonomik dhe grupeve etnike të ndryshme; për të tejkaluar varfërinë dhe mobilitetin energjitik dhe pabarazinë gjinore.

Aktorët	Partnerët	Donatori
Shoqëria civile, komuniteti	REScoop.eu Women Engage for a Common Future e.V. (WECF) Bündnis Bürgerenergie e.V. ELECTRA Energy – Social Cooperative Milieukontakt Shqipëri	Ministria Gjermane e Mjedisit, Mbrojtjes së Natyrës dhe Sigurisë Bërthamore, zbatuar nga programi EUKI





Projekti po zhvillohet në Rumani, Maqedoninë e Veriut, Shqipëri dhe Serbi, ku ka mungesa për sigurinë e ujit dhe menaxhimin e higjienës në zonat rurale, situatë që mund të shkaktojë pasoja serioze për mjedisin dhe shëndetin e popullatës. Qëllimi ynë është të përshtasim e të zhvillojmë më tej instrumentin e Ujit dhe Planifikimin e Sigurt të Higjienës (WSSP) në vendet e synuara. Projekti zhvillon metoda për analizën e rrishtit dhe vlerësimin e ujit e higjienës, duke treguar masat që mund të merren për të minimizuar rrishtin dhe përmirësuar situatën.



**Rezultatet:**

**01**  
Kualifikimi / trajnimi i 20 mësuesëve

**02**  
Kualifikimi / trajnimi i 30 nxënësve

**03**  
Teste të cilësisë së ujit në Tiranë dhe Lezhë, duke publikuar më pas rezultatet në një hartë të përbashkët me partnerët e projektit.

**04**  
Fushatë informuese dhe përfshirje të qytetarëve

**05**  
Promovim dhe angazhim të nxënësve të shkollave 9-vjeçare në ditë mjedisore, të cilat kanë lidhje të drejtpërdrejta me aksesin dhe cilësinë e ujit.

Aktorët	Partnerët	Donatori
Komuniteti pranë qytetit të Tiranës dhe Lezhës, Institucionet e arsimit mësuesit, nxënësit	WECF, Women in Development, Milieukontakt Albania, Acuadematica, Journalist for Human Rights, Environmental Ambassadors for Sustainable Development	Ministria Federale Gjermane e Mjedisit, Mbrojtjes së Natyrës dhe Sigurisë Bërthamore



## POLITIKA DHE LEGJISLACIONI MJEDISOR



Sektori E



## E. Politika dhe legjislacioni mjedisor



Prill 2016 – Shtator 2017 “HELP-CSO – Forcimi i legjislacionit horizontal dhe promovimi i CSO”

Shqipëria ka mangësi në informacion dhe pjesëmarrje efektive të publikut, duke çuar në shoqata mjedisore dhe individë të dobët. Ky fenomen vihet re sidomos në zhvillimin e projekteve të HEC-eve, ku për shkak të mungesës së njohurive ligjore mjedisore, procesi i pjesëmarrjes të publikut ka rezultuar konfliktual në komunitetet e prekura. Realizimi i projektit ka fuqizuar organizatat mjedisore lokale, duke ofruar shërbime ligjore falas dhe inkurajuar aktivitete me pjesëmarrje; ofrojë metodologjinë në monitorimin e gjendjes së mjedisit dhe rritjen e njohurive mbi legjislacionin horizontal, për të lobuar dhe advokuar për përafrimin me BE-në.



### Rezultatet:

**01**

U krijua një rrjeti i fortë dhe i përgjegjshëm i shoqatave mjedisore për të punuar së bashku për legjislacionin horizontal.

**02**

Rritja e kapaciteteve të shoqatave mjedisore në çështje gjyqësore strategjike, duke i ofruar këshillim ligjor dhe përfshirje të komunitetit.

**03**

Monitorimin e zbatimin e raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis në projektet e përzgjedhura me ndjeshmëri mjedisore.

**04**

Adresimin e gjetjeve të projektit në politika konkrete dhe propozime ligjore për autoritetet qeveritare dhe institucionet.

Aktorët	Partnerët	Donatori
Shoqëria civile, komuniteti, ekspertë të fushës	Milieukontakt Shqipëri, Eco Albania, Lex Ferenda	Programi Achive, mundësuar nga REC Shqipëri

## Tetor 2016 – Tetor 2018 “Fuqizimi i oponencës së VNM-ve”

Vendosja e një praktike për Oponencë Teknike Mjedisore në një VNM-të thelluar e cila do ndikojë në vendimmarrjen për projekte në fusha të ndryshme mjedisore si një praktikë e suksesshme të zbatimit të legjislacionit horizontal të informimit dhe përfshirjes së publikut në vendimmarrjen mjedisore. Fuqizimi i oponencës së VNM-ve nga Organizata të Shoqërisë Civile. (CO – SEED)



### Rezultatet:

**01**

Vendosja e bashkëpunimit efektiv mes shoqërisë civile dhe AKM-së për një proces sa më të plotë dhe transparent të VNM-së së thelluar; për minimizimin e pasojave në mjedis të një projekti të propozuar për zhvillim.

**02**

Një tryezë bisedimi me përfaqësues të Bashkisë Tiranë, për menaxhimin e mbetjeve të qytetit, si edhe dy tryeza me komunitet në zonë.

**03**

Rrjetëzim të OSHÇ lokale të afta të përfshihen në procesin e informimit, konsultimit dhe dëgjësive publike të VNM-ve të thelluara, duke monitoruar dhe raportuar situatën reale të zbatimit të ligjit.

**04**

Rekomandime ligjore dhe politike të zhvilluara për të përmirësuar zbatimin e legjislacionit horizontal të VNM-së së thelluar.

Aktorët	Partnerët	Donatori
Shoqëria Civile AKM	Milieukontakt Shqipëri, Qendra EDEN	Bashkimi Evropian përmes INCA Shqipëri



Projekti ka patur synim të informojë komunitetin rreth të drejtës së tyre për informim dhe ankimim. Komuniteti gjithashtu rriti njohuritë rreth praktikave abuzive e korruptive; duke ia rekomanduar më pas autoriteteve lokale për zbatimin e këtyre mësimëve në përditshmëri.



**01**

Informimi i komunitetit të 3 bashkive (Shijak, Ura Vajgurore dhe Libohovë) mbi të drejtën e informimit dhe të drejtën e ankimit.

**02**

Informimi i komunitetit dhe palët lokale të interesuara të 3 bashkive (Shijak, Ura Vajgurore dhe Libohovë) për evidentimin mbi praktikatat abuzive dhe korruptive dhe mënyrat e kundërshtimit të këtyre praktikave.

**03**

Rritja e aktivizimit të komunitetit dhe palëve të interesuara lokale në rritjen e vëmendjes kundrejt aktivitetit të administratës publike lokale, duke ndikuar në rritjen e cilësisë dhe mirëfunksionimit të saj.

**04**

Studim i realizuar nga ekspertë të shoqërisë civile dhe një ekspert ligjor mbi të drejtën e informimit dhe ankimit të komunitetit dhe evidentimi mbi praktikatat abuzive dhe korruptive në administratën publike.

Aktorët	Partnerët	Donatori
Shoqëria civile, komuniteti, palë lokale të interesit, ekspertë të fushës, Bashkitë Shijak, Ura Vajgurore dhe Libohovë.	Milieukontakt Shqipëri, CESVI, ARCI	Fonde të BE-së, me mbështetjen e IDM-së



## Donatorët dhe partnerët tanë

### DONATORËT TANË

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, BERZH, Belgrade Open School, Delegacioni i Bashkimit Evropian IPA CBC, GEF/SGP, GIZ Shqipëri, HELVETAS Swiss Intercooperation – Programi Bashki të forta, IADSA, Komisioni Evropian – Programi Horizon 2020, Lëviz Albania, MEDPOL, Ministria Federale Gjermane e Mjedisit, Mbrojtjes së Natyrës dhe Sigurisë Bërthamore, MedPol, PAP/RAC, Philipe Morris, Qeveria Suedeze, Qeveria Gjermane, Qeveria Zvicerane, REC, SCP/RAC, USAID përmes Projektit Zhvillimi dhe bashkëpunimi i përshpejtuar i Shoqërisë Civile, UNDP Shqipëri.

### PARTNERËT TANË

AJMMI Sarandë, ARCI, Acuadematica, Bündnis Bürgerenergie, Bashkia Përmet, CESVI, Co Plan, DOOR, Drejtoria e Ujërave të Epirit, Eco Albania, Eko Mjedisi, ELECTRA, Energy – Social Cooperative, ESF, EPER Center, Environmental Ambassadors for Sustainable Development, Focus, Grupimi ECIM, Green Center, GERES, IREC, INCA, Journalist for Human Rights, Klubi Ekologjik Elbasan, Klubi Ekologjik Krujë, Lex Ferenda, Pro Përmeti, Qarku Vlore, Qendra Aarhus Shkodër, Qendra EDEN, Rajoni i Ishujve Jonian, REScoop.eu asbl, SOGESCA, UAB, Vjosa Explorer, Women Engage for a Common Future (WECF), Woman in Development (WiD).

## Shikueshmëria dhe media

Përgjatë punës së përditshme ka qenë e nevojshme, por edhe e domosdoshme gjithashtu të paraqesim e të bëjmë të dukshëm aktivitetet tona.

Nismat, rezultatet e botimet e ndryshme i kemi publikuar në televizione, radio, median e shkruar dhe atë sociale.

“Nganjëherë fjalët nuk mjaftojnë.  
Atëherë nevojiten ngjyrat, format, tingujt dhe emocionet”.  
Alessandro Baricco



### Stafi Milieukontakt i ftuar në televizion

12 Shkurt 2020

Televizioni Top Chanel, emisioni “Shqipëria Live”, intervistë me znj. Valbona Mazreku, z. Arion Sauku, z. Nertil Lugji,  
“Zona më e ndotur në Tiranë, matje në kohë reale”.



**22 Qershor 2020**



TCH, programi “Shqipëria LIVE”: intervistë me z. Arion Sauku dhe z. Nertil Lugji rreth rezultateve të monitorimit përgjatë projektit “Mushkëri të gjelbërta për qytetet tona”.

**23 Qershor 2020**

SCAN TV: Intervistë me znj. Valbona Mazreku, “Problematikat mjedisore çështje mbarë botërore. Cilat janë burimet kryesore të ndotjes së ajrit?”



**25 Qershor 2020**



Travel Club: intervistë me z. Arion Sauku, “Rreth projektit GreenLung”.

**27 Qershor 2020**

Fox News: intervistë me z. Arion Sauku, “Rritet niveli i ndotjes së ajrit në Shqipëri”.



**10 Korrik 2020**



TV 1 CHANNEL: intervistë me znj. Bujana Xhindoli, “Turizmi i qëndrueshëm dhe promovimi i produkteve agro-ushqimore në zonën e Anës së Malit”.

**16 Tetor 2020**

Televizioni Scan: intervistë me znj. Valbona Mazreku rreth projektit “Fuqizimi i grave për të ndërmarrë veprime kundër varfërisë energjitike në Mesdhe”.



**Media e shkruar**

**24 janar 2020**

Gazeta shqip, Investigim: “Rruga e Elbasanit e deri tek 9-katëshet, zbulohen zonat më të ndotura të Tiranës”, shkruar nga: Bujana Xhindoli, Milieukontakt Shqipëri.



**31 janar 2020**



Fakteje.al, artikull nga Merzhan Daci, “Sa i ndotur është ajri në “Tiranë”

1 korrik 2019,

Yeent.eu: Artikulli “Radhima Visitor Center, a multi-functional place” shkruar nga znj.Bujana Xhindoli, Milieukontakt Shqipëri.



### “Kur periferia zптоhet nga mbetjet”



“Kur periferia zптоhet nga mbetjet”, reportazh ndërgjegjësues / sensibilizues për gjenerimin/ menaxhimin e mbetjeve urbane në rrethinat e qytetit të Tiranës, zona Yzberisht, Njësia Administrative Kashar, zona e Teleferikut dhe Freskut në Njësinë Administrative Dajt. Reportazhi u zhvillua në kuadër të Programit SENIORA-II, me mbështetjen e REC Shqipëri mundësuar financiarisht nga Ambasada Suedeze.

### “Përmeti perla mbi Vjosë”

Reportazh “Përmeti perla mbi Vjosë”, përgatitur në kuadër të projektit “Monitorimi dhe vlerësimi i shërbimit të menaxhimit të mbetjeve urbane në bashkitë Krujë, Përmet, Sarandë” me mbështetjen e LëvizAlbania.



### “Lëviz për Krujën”



Reportazhi përgatitur në kuadër të projektit “Monitorimi dhe vlerësimi i shërbimit të menaxhimit të mbetjeve urbane në bashkitë Krujë, Përmet, Sarandë” me mbështetjen e LëvizAlbania.



## “Saranda jo siç e duam ne”

Reportazhi përgatitur në kuadër të projektit “Monitorimi dhe vlerësimi i shërbimit të menaxhimit të mbetjeve urbane në bashkitë Krujë, Përmet, Sarandë” me mbështetjen e LëvizAlbania



## BOTIMET

### Botimet



Tradita është një pjesë e rëndësishme e identitetit tonë. Është ajo që na bën të veçantë dhe karakteristik në këtë hapësirë ku ne jetojmë. Pikërisht është kjo arsyeja që ne duhet ta rijetësojmë atë. Katalogu i Punimeve Artizanale Përmet na ndihmon për të realizuar rikthimin e kësaj tradite dhe do të shërbejë si një dritare për vizitorët brenda dhe jashtë vendit për t’u prezantuar me këto prodhime pjesë e kulturës së zonës së Përmetit. Në broshurë mund të gjendet informacion mbi punishtet dhe dyqanet e hapura nga artizanët lokal si dhe informacion mbi guidat lokale të përgatitur në kuadër të projektit.

## “Alternativa mjedisore për HEC-et e vegjël”

Në Shqipëri është një studim alternativ i sjell nga: shoqëria civile mjedisore në Shqipëri, që hulumton procesin e zhvillimit të shpejtë të sektorit të energjisë hidrike në të gjithë vendin, kundrejt ndikimit të vërejtur në mjedis dhe atij të pritshëm. Përfituesit direkt të këtij studimi janë komuniteti shqiptar, organizatat e shoqërisë civile, vendimmarrësit lokal, institucionet shtetërore në veçanti, sektori privat dhe media.



## “Fushata e monitorimit në institucionet arsimore në Tiranë”



52 institucionet arsimore të përzgjedhura brenda unazës së Tiranës janë monitoruar për të matur normën e PM2.5, PM10, CO2. Në Tiranë, pjesa më e madhe e shkollave janë të vendosura në zona të urbane, ku gëlojnë aktivitetet ekonomike dhe ndërtimore, e si pasojë mungojnë hapësira për të ndërtuar institucione të edukimit në zona të përshtatshme.

### “Strategjia e Menaxhimit të Riskut Bashkia Përmet”

Ky dokument përcakton parimet e përgjithshme të menaxhimit të riskut dhe është ndërtuar si pjesë e pandarë me Strategjinë e Zhvillimit Vendor për Bashkinë Përmet, duke menaxhuar risqet në vendimmarrje, vendosjen dhe arritjen e objektivave dhe përmirësimin e performancës në shërbim të komunitetit. Dokumenti përcakton standardet që duhen përdorur në procesin e kontrollit të shërbimeve vendore me qëllim që të arrihet një përdorim financiar.

STRATEGJIA E MENAXHIMIT  
TË RISKUT  
BASHKIA PËRMET

### “Rregullore Bashkia Roskovec”

Kjo rregullore ka për objekt krijimin e një kuadri rregullator për funksionimin me efikasitet të veprimtarisë së administratës së Bashkisë Roskovec, si dhe përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e stafit të saj dhe, mënyrën e bashkëveprimit të organeve të Bashkisë me të tretët, për realizimin e funksioneve dhe kompetencave të saj të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

RREGULLORE

### “Rregullore Bashkia Patos”

Kjo rregullore ka për objekt krijimin e një kuadri rregullator për funksionimin me efikasitet dhe efikasitet të veprimtarisë së administratës së Bashkisë Patos, përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e stafit të saj dhe, mënyrën e bashkëveprimit të organeve të Bashkisë ndërmjet tyre me të tretët, për realizimin e funksioneve dhe kompetencave të saj të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

RREGULLORE

### “Dëmet e Shkaktuara nga Fatkeqësitë Natyrore në Shqipëri”

Studimi është përqendruar më së shumti në një vlerësim të detajuar, lidhur me zonat dhe dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore përgjatë viteve 2014-2017, me vëmendje të veçantë tek përmbytjet. Ky dokument synon të ndihmojë institucionet dhe aktorët e interesuar të vlerësojnë gjendjen dhe nevojat për përmirësimin e saj. Specifikisht, nëpërmjet këtij studimi jepen dëmet në infrastrukturë, niveli i riskut të shtuar ndaj komunitetit, pronës dhe kafshëve dhe hartëzimi i zonave të prekura; si një ndihmë në dobi të punës së institucioneve, komuniteteve të prekura dhe publikut të gjerë.

DËMET E SHKAKTUARA  
NGA FATKEQËSITË NATYRORE  
NË SHQIPËRI

### “Analiza e menaxhimit të mbetjeve të ngurta bashkia Krujë”

Në këtë studim prezantohet shërbimi i pastrimit në bashkinë Krujë, ku janë marrë në shqyrtim kontratat e pastrimit, realizimi i saj për disa nga zërat, është bërë analiza financiare e shërbimit si dhe janë dhënë treguesit e performancës më vete dhe krahasimore mes bashkive të Përmetit dhe Sarandës. Pjesë e studimit është edhe një përmbledhje e performancës së shërbimit, bazuar në anketën e zhvilluar me banorët dhe bizneset, që ushtrojnë veprimtarinë në bashkitë përkatëse.



### “Analiza e menaxhimit të mbetjeve të ngurta bashkia Sarandë”

Në këtë studim prezantohet shërbimi i pastrimit në bashkitë pilote të projektit, merret në shqyrtim kontrata e pastrimit, realizimi i saj për disa nga zërat, bëhet analiza financiare e shërbimit si dhe jepen treguesit e performancës më vete dhe krahasimor mes bashkive. Pjesë e studimit është dhe një përmbledhje e performancës së shërbimit bazuar në anketën e zhvilluar me banorët dhe bizneset që ushtrojnë veprimtarinë në bashkitë përkatëse.



### “Analiza e menaxhimit të mbetjeve të ngurta bashkia Përmet”

Në këtë studim prezantohet shërbimi i pastrimit në Përmet, merret në shqyrtim realizimi i shërbimit nga Ndërmarrja e Pastrimit Gjelbërimit për disa nga zërat, bëhet analiza financiare e shërbimit si dhe jepen treguesit e performancës më vete dhe krahasimore mes bashkive pilot. Pjesë e studimit është edhe një përmbledhje e performancës së shërbimit, bazuar në anketën e zhvilluar me banorët dhe bizneset që ushtrojnë veprimtarinë në bashkitë përkatëse.



### “Direktiva e vlerësimit të ndikimit në mjedis”

Studim mbi përafrimin e legjislacionit shqiptar me direktivën e vlerësimit të ndikimit në mjedis: cilësia e raporteve, pjesëmarrja e publikut dhe aksesit në drejtësi. Ky studim përbën një vlerësim të mënyrës dhe nivelit të përafrimit të legjislacionit shqiptar për vlerësimin e ndikimit në mjedis si dhe në rastet kur për çështje të caktuara çmohet që ka nevojë për ndryshime në ligjin për vlerësimin e ndikimit në mjedis ose të akteve nënligjore në zbatim të tij; propozon ndryshime në të përputhje me parashikimet e direktivës 2014/52/EU.



## “Konfliktet ujore”

Qëllimi kryesor i këtij studimi është të vlerësojë konfliktet ujore të lidhura me zhvillimin e hidro-energjisë në vend, vlerësim i cili bazohet në të dhënat e grumbulluara sipas modelit të vlerësimit të Organizatave të Drejtësisë Mjedisore, Përgjegjësisë dhe Tregtisë (EJOLT). Ky studim vlerësues nxori në pah 18 raste të sigurta konfliktesh të lidhura me hidrocentralet që janë raportuar në Shqipëri gjatë periudhës 2012-2016.



## “Plani vendor i menaxhimit të mbetjeve urbane në bashkinë Shijak”



Plani Vendor i Menaxhimit të Mbetjeve Urbane është një dokument udhëzues dhe planifikues, i cili mundëson zbatimin e politikës kombëtare dhe rajonale të mbetjeve në nivel vendor, pra, mundëson orientimin strategjik të Bashkisë Shijak drejt një menaxhimi të integruar e të qëndrueshëm të mbetjeve. Qëllimi i këtij plani është të parashtrijë një përfaqje të qartë të politikave të menaxhimit të mbetjeve në nivel vendor, duke tentuar drejt një harmonizimi sa më të plotë dhe gjithëpërfshirës të interesave dhe qëndrimeve të përbashkëta midis aktorëve të ndryshëm të interesuar në menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve.

## “Vlerësimi i impaktit të ligjit të VNM-së në Shqipëri”

Për herë të parë vjen në Shqipëri një studim i detajuar mbi vlerësimin e kuadrit rregullator, ex-post, pregatitur nga OSHC-të, siç është ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.

Futja e procesit të Vlerësimit të Ndikimit është një domosdoshmëri e procesit të përmirësimit të politikave publike dhe legjislatonit në kuadër të integritimit në Bashkimin Evropian dhe përbën një ndryshim të rëndësishëm në punën e Qeverisë Shqiptare.



## “Zbatimi i Planit Strategjik të Qendrës së Vizitorëve Radhimë”



Botimi Zbatimi i Planit Strategjik Qendrës së Vizitorëve, synon promovimin e misionit të Qendrës së Vizitorëve të Zonës së Mbrojtur Detare Karaburun-Sazan në mbrojtje të pasurive unike natyrore dhe kulturore të zonës. Në të pasqyrohen aktivitetet e organizuara përmes angazhimit, informimit dhe edukimit të turistëve dhe banorëve për menaxhimin e qëndrueshëm të ZMD, duke rezultuar në përfitim ekonomik afatgjatë për të gjithë

## VIZIONI I SË ARDHMES

Milieukontakt Shqipëri ndërmerr partneritete për të përmirësuar cilësinë e jetës, duke rritur pjesëmarrjen e njerëzve dhe shoqërive për një zhvillim të qëndrueshëm.

Milieukontakt bashkëpunon me partnerë (ndër)kombëtarë, sepse problemet mjedisore nuk kanë kufi. Shumë nga sfidat aktuale mjedisore janë mbarë botërore. Në nivel lokal njerëzit mund të mbështeten dhe të mësojnë nga përvojat e të tjerëve që punojnë me të njëjtat probleme në pjesë të tjera të botës. Milieukontakt lidh njerëzit, organizatat dhe rrjetet që merren me të njëjtat sfida dhe duan të bashkëpunojnë drejt rritjes së pjesëmarrjes qytetare në përcaktimin e të ardhmes së tyre. Milieukontakt do të sigurojë njerëzit me mjetet dhe aftësitë për të përdorur mundësitë për pjesëmarrje, duke përfshirë trajnimin, këshillimin (ligjor) dhe asistimin. Proceset vendimmarrëse me pjesëmarrje janë thelbësore në këto partneritete. Milieukontakt fokusohet në ofrimin e mjeteve për pjesëmarrje në vendimmarrje dhe zbatimin e projektit.

**Ngritja e kapaciteteve** Të jesh një mjedisor do të thotë të mësohesh gjatë gjithë jetës dhe kjo e bën çështjen interesante dhe sfiduese! Për të qenë efektive, një lëvizje mjedisore kërkon një sërë aftësish që nuk mësohen lehtësisht në shkollë apo në universitet. Mjedisorët duhet të dinë për gamën e gjerë të çështjeve të mbuluara nga 'mjedisi'. Energjia, ndryshimet klimatike, mbeturinat, menaxhimi i ujit, kanalizimet, kimikatet dhe bujqësia janë disa nga çështjet. Mjedisori duhet gjithashtu të jetë në dijeni të zhvillimeve në qarqet shkencore dhe politike. Sot, çdo gjë lidhet me ndryshimin e klimës dhe atë që do ose nuk do të sjellë në të ardhmen. Ndaj njohuritë duhen përditësuar për të qenë një partner me qeveritë dhe palët e tjera të interesuara. Përveç njohurive mbi çështjet globale, duhet ditur se çfarë po ndodh në vendin, rajonin, qytetin apo fshatin për veprime më

efektive. Kjo do të thotë që mjedisorët vazhdimisht mësojnë dhe përshtatin njohuritë shkencore me punën e tyre të përditshme. Ata duhet t'i përkthejnë këto njohuri në politikë dhe veprime. Aftësitë e komunikimit janë thelbësore, siç janë ekspertiza ligjore dhe aftësitë negociuese. Ndonjëherë duhet t'i drejtohem gjykatës ose të negociojmë nëse, nuk ka ndonjë mënyrë tjetër. Ka shumë fusha të tjera në të cilat mjedisorët duhet të përgatiten për t'u bërë efektivë; p.sh si të jenë administrator të mirë, projektues, drejtues projekti, profesionist dhe të dinë se si të mundësojnë financimin e të gjitha punëve.


**Përfshirja e qytetarëve** Nuk ka pothuajse asnjë fushë përveç politikës mjedisore në të cilën përfshirja e qytetarëve është kaq e rëndësishme për suksesin e politikës qeveritare. Shumë çështje politike kanë të bëjnë me çështje të tilla si: sjellja, diferencimi i mbetjeve, lëvizshmëria, ruajtja e energjisë dhe mbrojtja e natyrës. Këto janë të gjitha fusha politike që mund të mbështeten nga instrumentet teknike dhe ligjore, por që në fund gjithmonë bazohen në mbështetjen e qytetarëve dhe në ndryshimin e qëndrimit dhe sjelljes. Milieukontakt zhvilloi metodologji për të frymëzuar qytetarët për të zhvilluar "Axhendën e Gjelbër" të tyre dhe, jo vetëm për t'u përfshirë në hartimin e politikave, por edhe për të qenë proaktive.

**Zgjidhja e problemeve mjedisore** Gjithçka që ka të bëjë me zhvillimin e një shoqërie të qëndrueshme. Për të arritur qëndrueshmërinë, duhet të zgjidhen problemet ekzistuese mjedisore dhe të zhvillohen koncepte (djep për djep), metoda (riciklimi) dhe mjete (pajisje me energji të ulët), për të parandaluar probleme të reja. Ndërtimi i kapaciteteve dhe përfshirja qytetare pa punuar në drejtim të zgjidhjes së problemeve nuk ka vlerë në arritjen e qëllimit.




## TRANSPARENCA DHE PASQYRAT FINANCIARE

Grafiku tregon të ardhurat financiare për vitin 2015- 2020. Këto të ardhura kanë qenë të qëndrueshme ndërmjet vlerave 260,000,000 – 410,000,000 Lekë.




Grafiku tregon fondet sipas burimeve të financimeve, ku peshen më madhe e zënë fondet nga projektet me organizatat e huaja (40-50%) dhe më pas ato nga fondacione dhe organizata donatore vendase (30%).




Grafiku tregon shpërndarjen e buxhetit për vitin 2015. Sipas shpenzimeve të kryera rezultojnë se 77% e fondit shkon për zbatimin e projekteve, ndërsa pjesa e mbetur ndahet në 2% për shpenzime administrative zyre, 4% ekspertizë, 5% shpenzime publike, 12% për paga dhe sigurime.

Shpërndarja e buxhetit 2015 sipas shpenzimeve




Grafiku tregon shpërndarjen e buxhetit për vitin 2018. Sipas shpenzimeve të kryera rezultojnë se 63% e fondit shkon për zbatimin e projekteve, 2% për shërbime publike, 4% për shpenzime administrative zyre, 14% për paga dhe sigurime, 17% ekspertizë.

Shpërndarja e buxhetit 2018 sipas shpenzimeve




Grafiku tregon shpërndarjen e buxhetit për vitin 2019. Sipas shpenzimeve të kryera rezulton se 76% e fondit shkon për zbatimin e projekteve, 12% për paga dhe sigurime, 9% ekspertizë, dhe pjesa e mbetur (3%) për shërbime publike, administrative zyre.

**Shpërndarja e buxhetit 2019 sipas shpenzimeve**



Grafiku tregon shpërndarjen e buxhetit për vitin 2020. Sipas shpenzimeve të kryera rezulton se 70% e fondit shkon për zbatimin e projekteve, 16% për paga dhe sigurime, 9% ekspertizë, dhe pjesa e mbetur për shpenzime administrative zyre e publike.

**Shpërndarja e buxhetit 2020 sipas shpenzimeve**



# Strategjia

Milieukontakt nuk mund të arrijë e vetme misionin e saj. Ne jemi pjesë e rrjeteve formale dhe joformale të njerëzve dhe organizatave që punojnë drejt përbushjes së misionit tonë. Aftësia për të bashkëpunuar me organizatat komunitare dhe me donatorët, qeverinë dhe biznesin ndërkombëtar, është një nga pikat e forta të Milieukontakt.

Ne krijojmë aleanca strategjike dhe partneritete me organizatat e shoqërisë civile, autoritetet, bizneset dhe institucionet ndërkombëtare aktive për zhvillimin e qëndrueshëm ose çështje të tjera që lidhen me këtë temë si gjinia, shëndetësia dhe arsimi.

Ne zhvillojmë, përdorim dhe lehtësojmë metodat e pjesëmarrjes, shkëmbimin e informacionit, analizën dhe veprimtarinë midis palëve të interesuara dhe lidhim këtë qasje me zgjidhje praktike, me kosto efektive dhe të qëndrueshme për sfidat mjedisore.

Ne bashkëpunojmë me shkencëtarë (social) dhe institucione kërkimore për të hulumtuar, analizuar dhe zhvilluar më tej qasjen e Milieukontakt dhe metodat e punës.

Ne do të zbatojmë në punën tonë të përditshme kodin tonë të sjelljes me rregullat për të luftuar korupsionin në projekte dhe nxitur partneritete.





**Web**

[www.milieukontakt.org](http://www.milieukontakt.org)



**Adresa**

**Rr.Xhorxhi Martini, Pall. Teuta Konstruksion, Shk.3, Ap.8  
Postal Code : 1017, Tiranë, Shqipëri**



**Email**

[office@milieukontakt.org](mailto:office@milieukontakt.org)  
[milieukontakt.al@gmail.com](mailto:milieukontakt.al@gmail.com)



**Telefon/Celular**

**+355 68 20 65 353  
+355 42 256 528**



MILIEUKONTAKT  
SERVING SOCIETY TOWARDS SUSTAINABILITY

# MILIEUKONTAKT ALBANIA

SERVING SOCIETY TOWARDS SUSTAINABILITY





MILIEUKONTAKT  
ALBANIA  
SERVING SOCIETY TOWARDS SUSTAINABILITY

